

Recension

Semantika e komunikimit

Mr. Agim Spahiu

23 mars 2000

Përmbledhje

(R.Bergentoft, M. Nord & S. Nord, *Grammaire française communicative*, Heidelberg, 1998, f. 151-248)

Studimet në fushën e gjuhësisë pragmatike tek ne janë në fazën fillestare. Ato mund të numërohen me gishtërinj. Me sa dimë unë deri më sot në gjuhën shqipe është botuar vetëm një studim i **Xhevat Lloshit** që i kushtohet kësaj fushe me titull **Stilistika dhe pragmatia**, botuar në Tiranë më 1999. Kurse në botë studimet e tilla kanë avancuar shumë. Sot në gjuhë të ndryshme kemi studime e gramatika nga më të ndryshmet të cilat i kushtohet në mënyrë të veçantë kësaj disipline gjuhësore e multidisiplinore. Prandaj këtu për lexuesit, e sidomos për studiuesit shqiptarë, e kemi parë të arsyeshme ta bëj një lloj prezantimi të një gramatike në gjuhën frënge, në të cilën për objekt studimi autorët kanë pasur pragmatikën, me elementet më themelore të komunikimit etj., me të vetmen arsye që ata të ndihmohen dhe të përvijohen në studimet e tyre të ardhshme.

Derisa në trevat shqiptare edhe sot e kësaj dite bëhen përpjekje në të gjitha nivelet shkollore të shpjegohen e të interpretohen nocionet themelore të gramatikës tradicionale-funksionale (nganjëherë edhe të avancohen ato nocione nga studiues të gjuhës), në vendet perëndimore, në mënyrë të organizuar institucionalisht, gramatikanët qysh moti u janë rrekur metodave të ndryshme shkencore të studimit të gjuhës, në të gjitha hallkat e sistemit dhe të nënsistemit të saj, duke krijuar kështu një mori modelesh gramatikore.

Këtyre ditëve na ra në dorë një gramatikë e re komunikative e gjuhës frënge, e ashtuquajtura **Grammaire française communicative** e autorëve: R. Bergentoft, M. Nord dhe S. Nord, e cila nga vetë materia që shtjellon, është shumë interesante dhe e rëndësishme që të prezantohet edhe për lexuesin dhe studiuesin shqiptar. Prandaj edhe kjo qe edhe arsyeja e prezantimit të saj, në pika të shkurtra, duke i bërë asaj më tepër një përshkrim të përgjithshëm, pa u ndalur në shumë hollësi.

Në parathënie të kësaj gramatike thuhet se prezantimi i pjesës nocionore të **Grammatikës komunikative frënge** është bazuar në punën efektive të Këshillit të Evropës

(Një nivel i vetëm dhe adaptimi i një niveli të vetëm për kontekstin shkollor) si dhe në pjesëmarrjen e CREDIF-it (Qendra kërkimore e studimore për difuzion të frëngjishtes)¹.

Vetëm kjo pjesë e gramatikës i ka rreth 100 faqe, me rreshta të dendur. Ka, po ashtu, edhe mjaft shembuj të qartë për ilustrim. Prandaj, për lexuesin shqiptar po e bëjmë një shpallim pak a shumë sipërfaqësor të kësaj **Gramatike**, me qëllim që edhe ai të ketë një ide se ç'përmbajtje ka dhe të shoh metodologjinë e punës së autorëve francezë në elaborimin e shumë çështjeve në këtë studim.

Libri ndahet në 4 pjesë:

1. Dhënia e informacioneve faktike,
2. Reagimet e duhura (përkatëse) në bashkëbisedim,
3. Aktet sociale, dhe
4. Operacionet ligjërimore.

Në pjesën e parë përfshihen 11 njësi. Po i përmendim disa nga temat e njësisë 1. si p.sh.: **Bërja e një hipoteze për një gjë që është e vërtetë** (e këtu janë përfshirë temat si: **Hipoteza e thjeshtë**/ *Supozoj + se.../ Imagjinoj + që...* /; **Eventualiteti** /*Në rast se bie borë, unë nuk dalë fare/ Po ra borë, nuk do ta marr veturën*/; dhe **irealiteti**/; **Paraqitja e një gjëje si e vërtetë/ jo e vërtetë/ e sigurt** etj. (e këtu janë përfshirë edhe temat që kanë të bëjnë me **domosdoshmërinë, mundësinë**/(p.sh. *Është e mundur që miku im të jetë i sëmurë*)/; **pamundësinë, dukjen e jashtme -përngjasimin; pasigurinë** etj.); **Insistimi mbi një gjë emfatike, ku bëhet fjalë për emfazën intensive**/p. sh.: *Unë deklaroj + se.../ Unë them + se...* etj/; **në aktet pohuese, në fjalitë pohuese, në një përbërës të fjalisë pohuese, kur synohet t'i vihet theksi afektiv**/ p.sh. *Ai është i vogël: ai është i vocërr*/. Këtu bëhet fjalë edhe për **enfazën opozitive** dhe, në mes tjerash, flitet për të ashtuquajturin **theks intelektual** që vihet mbi një fjalë të caktuar të fjalisë; **për transformacionet e fjalëve në fraza të caktuara**, p. sh. në fjalinë: *Daja im ka blerë një kalë*; mund të bëhet segmentimi opozitiv i secilës fjalë veç e veç/ kështu: në vend të sintagmës: *daja im* mund të kemi *babai im* ose *vëllai im*; ose në vend të: *ka blerë* mund të kemi *ka dhënë*; ose numërorit *një një qen* mund t'i themi: *dy, tre, katër* etj., e kështu me radhë; **Deklarimi (shpallja), informimi për një gjë që sajohet me foljet përkatëse në fjalitë kryesore a drejtuese**,/p. sh.: *Unë ju deklaroj/ them/ informoj + se...*; **Sinjalizimi, paralajmërimi** etj., i sajuar me foljet përkatëse, po ashtu, në fjalitë drejtuese, por edhe me foljen *kujdes* dhe shprehjen foljore *kini kujdes* etj.; **Të përkujtuarit, të përsëriturit**, me foljet përkatëse/ p.sh. *Po ta përkujtoj + se ; po ta përsëris + se... në fjalitë kryesore etj* ; **Dhënia e mendimit të vet mbi vërtetësinë e një gjëje** me foljet përkatëse: *di, kujtoj, përkujtoj, konsideroj, pretendoj, mendoj, imagjinoj, supozoj; jam i sigurt + se...etj.*; **Të presupozuarit për një gjë që është e vërtetë me foljet përkatëse**, si p. sh. *presupozoj + që/ se.../ pres + që*; me foljet aspektore, të atribucionit etj².

¹Shih vep. e cit., f. 151.

²Shih vep. e cit., f. 151- 162.

Në këtë kapitull janë të rëndësishme edhe njësitë **Pragmatika dhe afektiviteti**³.

Në kuadër të **Pragmatikës** flitet për ndërtimet që shprehin detyrim/obligim si: *Është e nevojshme/e obligueshme/ obligim + të bëhet...; kur bën të flohtë, ata mbyllen brenda; detyra ime është+ të bëj...; X më ka dhënë urdhër + të bëj...; Është e ndalur + të bëjmë...; që shprehin vullnet, kompetencë, kapacitet, motivacion, qëllim, dispozi- cion subjektiv e objektiv etj*⁴.Ndërsa në kuadër të **Afektivitetit** flitet për *admir- imin* /p.sh.: *Unë ju admiroj për këtë shkrim; Mrekulli! / për simpatinë / Kam simpati për dikë; E simpatizoj këtë ide; për antipatinë* /p. sh.: *Kjo ide më është antipatike; Brigita nuk më është simpatike; konsiderata* /p.sh.:*Unë kam shumë konsiderata për X Y;Indiferencë* / p. sh.: *Punë e madhe ! E atëherë ?, Eh, Ç' më bën !? Satisfaksion e kënaqësi* /p.sh.:*Kënaqem/gëzohem/ kur të shoh; Çfarë satisfaksioni !/ kënaqësie !, Fascinim*, p.sh. *Kjo teori më facinon; Jam fascinuar shumë nga origjinaliteti juaj; Kjo është gjeniale !/ fascinante !; etj.*

Nga vetë titulli i kapitullit të dytë **Reaksionet e duhura në bashkëbisedim** shihet se kemi të bëjmë me gjuhën e dialogut. Edhe këtu janë disa tema që janë për t'u veçuar, si p. sh.: **Aktet specifike dhe jospecifike**.

Në këtë temë janë zberthyer mjaft njësi me shembuj konkretë. Këtu fillohet me disa akte të thjeshta në të folur që i pranon bashkëbiseduesi, si: *po, mirë, ani, ah! apo! ah po? qetësi!* etj.; pastaj vihet në dukje **aprovimi i thënjëzimit**, p. sh.: *Ju falemnderit për sinqeritetin tuaj*⁵ dhe **aprovimi i thënies**, si p. sh.: *Po, absolutisht. Natyrisht. Kjo është e saktë*⁶; si **dhe joaprovimi i tyre**. Në këtë pjesë flitet edhe për përgjigjet pohuese nga fjalitë pyetëse pozitive të tipit: *Pali ka ardhur?*, si një e dhënë që është e vërtetë. E ato përgjigje janë: *Po. Po, po. Pali ka ardhur. Ai ka arritur*; etj.; **për përgjigjet pohuese nga fjalitë e parashtruara pyetëse negative të tipit**: *Pali nuk ka ardhur?*, kemi këto përgjigje: *-Jo. -Jo, jo. -Pali nuk ka ardhur. -Ai nuk ka arritur; Për përgjigjet mohuese nga fjalitë pyetëse pozitive të tipit*: *-Pali ka ardhur?*, kemi këto përgjigje: *-Jo. -Jo, jo. -Jo, ai nuk ka ardhur*⁷; e kështu me radhë.

Ndërkaq, në kuadër të **akteve jospecifike** kemi **mosaprovimin e shprehjeve**, pastaj **përgjigjet e përsëritjes, perafrastike, të precizitetit, të arsyes, të konsekuencës, interpretimi i thënjëzimit etj**⁸. Në kapitullin e tretë, **Aktet sociale** përfshihen njësitë të cilat kanë të bëjnë me **përrshëndetjet, prezantimin e dikujt dhe të vetvetes, urimet dhe dëshirat për diçka etj**⁹.

Dhe, së fundi, në kapitullin e katërt, **Operacione ligjërimore**, flitet për disa aspekte, si p. sh. për **aspektin referues**, e këtu përfshihen **Citatet** si p. sh. *Unë citoj:....., fundi i citatit*¹⁰; **Ilustrimet me shembuj** si p. sh.: *Ja një shembull....; ..., për shembull,...etj.; Shpjegimet, krahasimet, analizimet, përkufizimet, klasifikimet, përfundimet* (

³Po aty., f. 188- 208.

⁴Vep. e cit., f.190- 199.

⁵Po aty, f. 213.

⁶Po aty, f. 215.

⁷Vep. e cit., f. 221- 222.

⁸Po aty, f. 209- 210.

⁹Po aty, f. 232- 236.

¹⁰Po aty, f. 237.

p.sh.: *Për rezymim, unë them se...; etj.*); **aspektin kuantitativ, metalinguistik, korrektiv, dialogjik** (ku flitet për bashkëbisedimin), **formal**(ku flitet **për konkluzionet e ndryshme** në ndërtime si p. sh.: *Për përfundim,...; Në përfundim...; Për rrjedhim,...; Si përfundim mund të themi + se...; për digresionet e ndryshme* që mund të bëhen në ligjërim); dhe *aspektin vokal*¹¹.

Kjo **Gramatikë komunikative**, ndonëse në një gjuhë të huaj, paraqet një mënyrë të re të studimit të gramatikës, edhe për gjuhën shqipe do të përbënte një model të mirë në hartimin e mëvonshëm të një gramatike të këtij lloji.

Botuar,së pari, në **Koha DITORE**, më 24 mars 2000, f. 16.

¹¹Po aty, f. 248.